

2011: VITI EVROPIAN I VULLNETARIZMIT

Vullnetarizmi kontribuon për një shoqëri më të mirë



Viti 2011 është emëruar si Viti Evropian i Vullnetarizmit (VEV), në mënyrë që të joshë publikun për t'u paraqitur vullnetarë. Rëndësia e vullnetarizmit pothuajse gjithnjë është pranuar nga BE-ja, kurse tani me emërimin e VEV 2011, BE-ja ka për qëllim të informojë opinionin publik mbi beneficimet e vullnetarizmit. Këtë vit do të inkurajohet mirëkuptimi për rëndësinë e vullnetarizmit në krijimin e shoqërisë më demokratike, më dashamirëse dhe me përgjegjësi.

Qëllimet kryesore janë:

- promovimi i vullnetarizmit midis qytetarëve të Evropës
- përkrahja dhe përforcimi i organizatave vullnetare të Evropës
- përmirësimi dhe njohja e punës vullnetare dhe sfidat me të cilat përballet
- lartësimi i angazhimit të miliona vullnetarëve nga Evropa, të cilët përkushtohen për të mbështetur njerëz, kauza ose komunitete, goftë përbrenda BE-së apo jashtë.

Përfitimet nga vullnetarizmi

Vullnetarizmi në BE jep kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e eko-

nomisë, shoqërisë dhe individit. Vlerësimet sugjerojnë se vullnetarizmi kontribuon nga 0.5% deri në më se 5% të Prodhimit Bruto Nacional të vendeve të BE-së. Vullnetarizmi ka ndikim të rëndësishëm mbi shoqërinë, pasi që vullnetarizmi është shprehje reale e shtetësisë aktive, e cila përforcon disa nga vlerat elementare evropiane: solidaritetin dhe kohezionin social. Vullnetarizmi është gjithashtu mundësi për individët që ofrojnë ndihmë, të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të përmirësojnë vetëbesimin, ndërkohë që zvogëlojnë rrezikun e izolimit social.

Llojet e aktiviteteve vullnetare

Aktivitetet vullnetare realizohen në disa sektorë të ndryshëm. Në më shumë se gjysmën e vendeve të BE-së, shumica e vullnetarëve janë aktiv në fushat e sportit, ushtrimeve dhe aktiviteteve në ajër të pastër. Fusha të tjera të përhapura janë mirëqenia sociale dhe shëndeti, bamirësia dhe organizatat fetare, organizatat kulturore, rekreacioni dhe koha e lirë, organizatat arsimore, trajnimi dhe hulumtimi.



Niveli i vullnetarizmit në BE

Edhe pse rreth 23% të evropianëve të moshës mbi 15 vjeç janë të angazhuar në punë vullnetare, statistika tregon se ka dallime të mëdha në nivelin e paraqitjes së vullnetarëve në vendet anëtare të BE-së. Mirëpo, çdo shtet ka një definicion të ndryshëm për paraqitjen e vullnetarëve dhe mënyrën e evidentimit të këtij aktiviteti, kështu që është shumë vështirë të bëhen krahasime ndërkombëtare. Mungojnë të dhëna të krahasueshme ndërkombëtare për aktivitetet vullnetare. Në këtë mënyrë, gjatë 10 viteve të kaluara, ka ekzistuar një trend rritjeje në numrin e vullnetarëve aktivë dhe organizatave vullnetare në BE.

Korniza ligjore

Nuk ekzistojnë ligje të përbashkëta të BE-së mbi vullnetarizmin, pikë së pari për shkak të natyrës së ndryshme të vullnetarizmit dhe ndërlkueshmërisë të sektorit vullnetar në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Gjendja momentale është si vijon:

- 1) shtetet anëtare me kornizë ligjore që është posaçërisht e dedikuar për vullnetarizmin: Belgjika, Qiproja, Republika Çeke, Hungaria, Italia, Letonia, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja;
- 2) shtetet anëtare, të cilat nuk kanë kornizë ligjore por ku vullnetarizmi trajtohet në bazë të ligjeve të përgjithshme ekzistuese: Austria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Lituania, Holanda, Suedia dhe Britania e Madhe;
- 3) shtetet anëtare që janë në procesin e hartimit të kornizës ligjore: Bullgaria, Sllovakia dhe Sllovenia.

Rekomandimet në fushën e vullnetarizmit

Rekomandimet në nivel të BE-së dhe fushata për ngritjen e vetëdijes mbi Vitin Evropian të Vullnetarizmit 2011, do t'i ndihmojnë shoqërisë civile dhe qeverive për t'u ballafaquar me këto sfida dhe të fillojnë punën për ndryshimet e nevojshme dhe përfituese. Shtetet anëtare do të shqyrtojnë nëse diku duhet të ndryshohen ligjet ose të vënë në fuqi legjislacion të veçantë, për të promovuar vullnetarizmin, për të mbrojtur vullnetarët dhe për të hequr pengesat e panevojshme ligjore.

Bërësit e politikës do të inkurajohen të marrin parasysh ndjeshmërinë e aktiviteteve të Vullnetarizmit, të cilat dallohen nga aktivitetet profitabile, kur bëhet fjalë për ligjet e kompensimit të shpenzimeve të vullnetarëve, mbrojtjen e vullnetarëve derisa i zbatojnë aktivitetet vullnetare (si p.sh. mbulesa e sigurimit), trajtimi i OJQ-ve në thirrjet e hapura për tender dhe distribuimin e granteve, si dhe lehtësimin e kushteve për vullnetarizmin ndërkombëtar. Vendet me strukturë të qartë ligjore mbi vullnetarizmin, siç janë Belgjika ose Polonia, mund të merren si shembuj pozitivë drejt përmirësimit të kushteve të vullnetarizmit përbrenda BE-së.

Sfidat e vullnetarizmit

Përkundër beneficioneve të panumërta të vullnetarizmit, ekzistojnë gjithashtu edhe sfida në sektorin vullnetar në mbarë BE-në.

Disa nga ato janë:

- korniza e pështjelluar ligjore dhe rregullative dhe mungesa e trajtimit të njëtrajshëm në mbarë BE-në;
- mungesa e mbikqyrjes dhe informimit mbi vullnetarizmin, mungesa e grumbullimit të të dhënave dhe hulumtimit;
- mungesa e njohjes zyrtare ose miratimi i punës dhe eksperiencës vullnetare;
- problemi me perceptimin e vullnetarizmit nga opinioni publik në disa vende;
- nevoja për financim të vazhdueshëm të sektorit vullnetar, sidomos tani kur shumë vende janë duke i redukuar rreptësisht shpenzimet publike – burimi tradicional i financimit të organizatave vullnetare.

